

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“International Studies Academy of Albania (ISA)” sh.p.k

Sot, me date 09.11.2022 u paraqiten palet e meposhtme:

ORTAKET/THEMELUESIT.

1. **Albana Shehaj**, atësia Axhem, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, lindur më 28/07/1974, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 032868993 dhe nr. personal H45728070B
2. **Alda Muskaj**, atësia Remzi, amësia Sheqere, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, lindur më 09/02/1973, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 032663095 dhe nr. personal H352091310

Te cilet, konform ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, shpreh vullnetin e lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

KREU 1

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1.1 Sot ne daten e nenshkrimmit, me 09.11.2022 u themelua shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“International Studies Academy of Albania (ISA)” shpk.**

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Albana Shehaj**, atësia Axhem, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, lindur më 28/07/1974, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 032868993 dhe nr. personal H45728070B
- **Alda Muskaj**, atësia Remzi, amësia Sheqere, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, lindur më 09/02/1973, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 032663095 dhe nr. personal H352091310

NENI.2

OBJEKTI I SHOQËRISË


2.1 *Objekt i kesaj shoqërie do te jete:*



- T'ju siguroje studenteve si te nivelit te pare, te dyte, dhe pasuniversitar ndihme dhe konsultim ne nivel te larte ekspertesh per te pergatitur gjithë proceduren administrative te aplikimit, per te siguruar bursa nga institucionet nderkombetare qe ofrojne bursa studimi si dhe te rrise mundesine e studenteve qe te pranohen ne Univesitetet lider ne bote.
 - Te pergatise gjithë dokumentacionin e nevojshem te aplikimit per studimet Master dhe P.H.D. si dhe per intelektualet e rinj qe deshirojne te studjone ne Universitete me Prestigjose te UK, EU dhe USA.
 - Nepermjet projekteve shkencore te mundesoj ekspertize te larte akademike jo vetem studenteve te te gjitha niveleve por edhe profesionisteve te rinj, punonjes si ne sektorin publik ashtu edhe ne ate privat.
 - Duke bashkepunuar ngushte me Universitetet dhe botuesit akademike per te siguruar studimet dhe botimet e fundit bashkekohore te cilat do te ndihmojne studentet dhe profesionistet e rinj ne pergatitjen e temave te masterit dhe te doktoratures dhe ne botimet e tyre profesionale.
 - Ekspertet tane te shkrimeve akademike, jane te nje niveli shume te larte shkencor te trajnuar ne Universitetet elitar ne Europe, UK, dhe USA.
 - Te pergatise studentet e rinj dhe te ndihmoje ata duke i orientuar me kuadrin e plote te metodave te kerkimit shkencor bashkekohor.
 - Te siguroj dhe ofroje trajnime per te ndihmuar studentet te jene te sukseshem ne aplikimet e SAT, TOEFL, GRE, GMAT, Temat e Masterit, te Doktoratures, dhe post-Doctoratures.
 - Te organizoje aktivitete dhe takime prezantuese midis studenteve dhe perfaqesuesve te Universiteteve te cilat do te ndikojne drejteperdrejte ne rritjen e mundesive te studenteve per te siguruar nje burse studimi ne keto universitete.
 - Te pergatise dokumentacionin e nevojshme per paisjen me vize te studenteve, t'ju siguroje atyre gjithë informacionin e duhur per te lehtesuar gjithë proceduren e aplikimit, si dhe te ndihmoj deri ne sistemin e tyre ne Universitete perkatese.
 - Gjithashtu shoqeria do te kryeje dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar nga legjislacioni apo aktivitete ndihmese te veprimtarive si me siper.
- 2.2 Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3 KOHEZGJATJA

3.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar e aktiviteti i shoqerise mund te mbyllet sipas vendimit te Asamblese se ortakeve.




NENI. 4

SELIA E SHOQERISE

- 4.1 Shoqëria e ka selinë në adresën TIRANE Njesia Bashkiake 2, Rruga e Elbasanit, Pallati 2G, Shkalla 1, Kati 2, Ap 5.
- 4.2 Shoqëria mund të hapë edhe zyra perfaqesie, dege, të krijojë filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve të marre me shumicë të thjeshtë votash.

KREU II KAPITALI

NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara është 10.000 (dhjetemije) Leke.
- 5.2 Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.
- 5.3 Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin si vijon:
- 5.3.1 Ortaku Themelues, **Albana Shehaj**, zoteron **1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5.100 Leke (pesemije e njeqinde)** që përbën 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.3.2 Ortaku Themelues **Alda Muskaj** - zoteron **1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 4.900 Leke (katermije e nenteqinde)** që përbën 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI. 6


ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nenshkrimeve të pjesëve të kapitalit të regjistruar për kontribute në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin të regjistruar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohej për ndryshimin e statutit.

NENI. 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen si më poshtë:



- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

7.2 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar, me kufizimet e percaktuara ne pikat 7.3 dhe 7.4 me poshte.

7.3 Ne rast se njeri nga ortaket kerkon te shese nje pjese ose te gjitha kuotat qe ai zoteron ne shoqeri, ai eshte i detyruar qe t'ia ofroje paraprakisht keto kuota ortakut tjeter te shoqerise me te njejtin çmim qe ai ka vendosur t'i shese ato. Kjo oferte do te quhet e marre nga ortaku tjeter dhe/ose nga shoqeria, ne momentin e depozitimit te saj ne seline e shoqerise.

7.4 Ne rast se ortaku tjeter i shoqerise, brenda 3 muajve nga data e depozitimit te ofertes nuk pergjigjen per kete oferte, ose refuzojne oferten, ortaku ofertues ka te drejte t'ia shese kuotat e tij paleve te treta lirisht mjafton te provoje qe ortaku tjeter nuk ka perfituar nga e drejta e parablerjes.

7.5 Pergjegjesia e ortakeve per humbjet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

7.6 Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë pergjigjen në mënyre solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e rregjistrimit të kalimit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI. 8

ORGANET VENDIMMARRESE

8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

8.2 *Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:*

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Miratimi i bilanceve

- h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l) Miraton rregulla procedurale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji.

8.3 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E Mbledhjes SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike ne adresat e deklaruar te ortakeve. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve ne adresat e deklaruar ne shoqeri, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 9.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

NENI 10

MARRJA E VENDIMEVE DHE KUORUMI

- 10.1 Ne rastin e marrjes se cdo vendimi, Asambleja e pergjithshme mund te marre vendim te vlefshem ne cdo rast vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kapitalit, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit te posacem.
- 10.2 Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiperem nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.
- 10.3 Asambleja e pergjithshme vendos **me ¾ e votave te zoteruesve te kapitalit** te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, kufizimin e kompetencave te administratorit.
- 10.4 Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtjen te tjera.
- 10.5 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane **QKB** per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.




NENI 11
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

11.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria

11.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 12
ADMINISTRIMI

12.1 Asambleja e pergjithshme emerone me shumice te thjeshte te votave te zoteruesve te kalitalit nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 3 vjet me te drejte ripерteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKB.

12.2 Administratori i shoqerise ka te drejta te administrimit te veprimtarise se zakonshme te shoqerise per kryerjen e veprimeve te administrimit te zakonshem te pasurise se luajtshme e te paluajtshme te shoqerise deri ne vleren 5000 Euro.


12.2.1 Tagrat e tij kufizohen ne kryerjen e administrimit te zakonshem te shoqerise duke patur te drejte te kryeje cdo veprim me pale te treta, me Banka te Nivelit te Dyte, Institucione financiare jo bankare, transferta e pagesa, perfaqesim prane cdo institucioni tjeter, negocim dhe nenshkrim te akteve te nevojshme e kontrata te ndryshme por deri ne vleren 5000 Euro.

12.2.2 Per vlere qe kalojne kete kufi duhet marre vendimi i Asambleses sipas parashikimeve te nenit 10.3 te ketij statuti.

12.2.3 Per cdo marrje kredie, huaje, vendosje kolaterali apo cdo produkt tjeter bankar pavaresisht vleres se tij kerkohet detyrimisht vendim asambleje sipas parashikimeve te nenit 10.3.

12.3 Administratori ka te drejte te kryejë vetëm ato veprime të cilat kanë të bëjnë me administrimin e përditshëm dhe të zakonshëm të shoqërisë dhe brenda kufijve vendosur ne kete statut. Administratori mund të japi prokura tek të tretët brenda kufijve që ligji e lejon dhe në kufijtë që i lejon Asambleja e Ortakut për kategori të caktuara veprimesh.

12.4 Administratorit nuk i lejohet të kontraktojë me të tretët në çfarëdo lloj forme qoftë, nuk i lejohet të marri hua tek shoqëria, të japi pëlqimin për ceshtje të ndryshme në emër të saj, nuk i lejohet të japë paradhënie, të bëhet dorëzanës apo të garantojë në emër të shoqërisë apo të ortakëve etj, përveç rasteve kur ai ka marre një miratim përkatës me shkrim nga asambleja e ortakut.



12.5 Të gjitha veprimet e tjera duke përfshirë pagesa, detyrime për tu paguar, veprime me insitucionet bankare ku përfshihen transferta bankare tërheqje parash etj, do të kryhen nga administratori vetëm brenda kufijve caktuar me kete statut.

12.6 Administrator i shoqerise per nje afat tre vjecar me te drejte ripërteritje caktohet: **Alda Muskaj** atësia Remzi Telharaj, amësia Sheqere Telharaj, shtetase Shqiptare, lindur në Vlore dhe banues në TIRANË, me adresë RR Komuna e Parisit, pallati Alban-Tirana, Tiranë, madhore, zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim nr. BB8431909 dhe nr. Personal ID H352091310.

NENI 13

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

13.1 *Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:*

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji.

13.2 Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte. Në asnjë rast Asambleja nuk i duhet të justifikojnë apo provojë se cilat janë shkaqet për të cilat ai shkarkon administratorin. Në cdo rast është Asambleja organi kompetent qe vlerëson se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit.

NENI 14

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT



- 14.1 Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ndaj të tregëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Administratorët të cilët kanë kryer veprime ose bërë marrëveshje të pa aprovuara nga asamblëja, janë përgjegjës për demot e sjellja shoqërisë dhe përgjigjen personalisht ose solidarisht për pasojat.
- 14.2 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar të demshperblejë shoqërisë demot që rrjedhin nga kryerja e shkeljes së dhe të kalojë shoqërisë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

KREU IV
VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 15
VITI FINANCIAR

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 Dhjetor, Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.

NENI 16
EKSPERTET


- 16.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tëregëtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 16.2 Në përmbushje të kësaj detyrë eksperti kontabel i autorizuar për të gatitur raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 17
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

17.1 Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqërisë
- b) Me vendimet e asamblës së Ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentit
- d) Nëse nuk zhvillon aktivitet tëregëtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar përzullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,



e) Me vendim gjykate.

NENI 18

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

18.1 Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

NENI 19

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

19.1 Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jete te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren

19.2 Ndalimi i pikes 19.1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 20


MOSMARRVESHJET

20.1 Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

20.2 Ky akt themelimi dhe statut, u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET/THEMELUESIT

Albana Shehaj



Alda Muskaj

